



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:089479

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06205546

APS.nr.16/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Kreshnik Radoniqi – kryetar i kolegjit, Vaton Durguti dhe Mentor Bajraktari – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në lëndën penale kundër të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.35/2023 të datës 01 mars 2023 dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve L.D. av. M.Z.S., K.H. av. R.K. dhe O.H. av. Rr.A., të ushtuara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.36/23 të datës 07.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 09.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e pjesshëm të ankesave të mbrojtësve të akuzuarve L.D. av. M.Z.S., K.H.-av. R.K. dhe O.H. - av. Rr.A., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.36/23 i datës 07.12.2023, përkitazi me sanksionin penal ashtu që kjo Gjykatë të akuzuarit L.D., O.H. dhe K.H. për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së,

secilin veç e veç e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj burgim, në të cilën dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 12.04.2023 e deri me datë 07.12.2023. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

II.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.35/2023 e datës 01 mars 2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special me aktgjykimin PS.nr.36/23 të datës 07.12.2023 të pandehurit L.D., K.H. dhe O.H. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 nen par.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së dhe për këtë vepër penale të pandehurit L.D. i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurit K.H. i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurit O.H., i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në masën e paraburgimit dhe në masën e arrestit shtëpiak prej datës 12.04.2023, e deri me datë 07.12.2023, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë,

Në mbështetje të nenit 366 lidhur me neni 181 par.7 të KPP-së, të pandehurve L.D., K.H. dhe O.H., i është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak, pasi që kanë pushuar kushtet ligjore për masën e njëjtë.

Janë obliguar të pandehurit se cili veç e veç që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind (100) e, ndërsa shumën prej njëqind (100) €, për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguajnë në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V.S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, për shkak të vendimit mbi dënimin e shqiptuar nga neni 387 par.1 të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar kurse aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të pandehurve t'i shqiptoj dënim me burgim me kohëzgjatje më të lartë.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.D., av. M.Z.S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar lidhur me pjesën e dënimit dhe të pandehurit t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av. R.K., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar 1.1 dhe vendimit mbi sanksionin penal nga neni 387 të KPP-së, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të pandehurit K.H. t'i shqiptoj dënim me kusht ose dënim më të butë me burgim.

Mbrojtësi i të akuzuarit O.H., av. Rr.A. , për shkak të shkeljeve esenciale nga neni 384 par.1, nënpar 1.7 të KPP-së dhe Vendimit mbi sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim, ose ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të pandehurit O.H. t'i shqiptoj dënim me kusht ose dënim më të butë me burgim.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I.nr.244/2024 të datës 02.05.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës, ashtu që të akuzuarve t'i shqiptohet dënim me burgim me kohëzgjatje më të lartë, ndërsa ankesat e

mbrojtësve të të akuzuarve L.D., av. M.Z.S., K.H. av. R.K. dhe O.H., av. Rr.A., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 të KPP-së, seancën e kolegjit të caktuar për datë 27.08.2024 për shkak të mosplotësimit të kushteve e ka shtyrë për datën 09.09.2024 duke i njoftuar gojarisht të pranishmit për këtë seancë, ndërsa të mos pranishmëve të tjerë gjegjësisht të akuzuarve i është dërguar njoftimi me kohë dhe me rregull nëpërmjet postës për këtë seancë, (gjykata edhe nëpërmjet nr. të telefonave si në shkresat e lëndës kishte tentuar që ti kontaktoj dhe njoftoj të njejtit) i dëmtuari V.S. nuk ka prezantuar ndërsa përfaqësuesi i tij ligjor av. K.P. kumtoi se i njëjti është në dijeni për seancën por nuk do të prezanton, për të akuzuarin L.D. nga fletë kthesa rezulton se njoftimi me dt.06.09.24 i është lënë me raport, për të akuzuarin K.H. është konstatuar se është i panjohur në adresën si në shkresat të lëndës (*gjë që ishte obligim i tij për të paraqitur nëse kishte ndërruar adresën e banimit*) ndërsa O.H. kishte pranuar njoftimin me dt.30.08.2024 si rezulton nga fletë kthesa, ndërsa mbrojtësi R.K. për shkak të kalimit në detyrë tjetër (noter), nuk ka prezantuar në seancë. Në seancë të kolegjit mbrojtësit e të akuzuarve kanë njoftuar se me të mbrojturit e tyre nuk kanë komunikim.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së, vlerësoi pretendimet ankimore, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se: **Ankesat e mbrojtësve të akuzuarve pjesërisht janë të bazuara ndërsa ankesa e PSRK-së nuk është e bazuar.**

Pretendimet ankimore

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës përmes ankesë konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve nga gjykata e shkallës së parë është i butë dhe në disproporcion të thellë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, peshën e së njëjtës si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve. Prokurori pretendon se gjykata është dashur t'i kushtoj rëndësi të veçantë rrethanave të paraqitura si në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar si dhe mënyrës së kryerjes së veprës penale, këmbëngulësinë dhe vendosmërinë për kryerjen e veprës penale, peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe nëse do të merreshin parasysh këto rrethana ndaj të pandehurve do të shqiptohej një dënim më i rëndë. Sipas prokurorit me këto dënime nuk do të arrihet efekti i dënimit, as rehabilitimi i të pandehurve

si dhe as qëllimi i parandalimit të pandehurve në përsëritjen e veprës penale dhe parandalimi i kryerësve potencial për kryerjen e veprave të tilla, andaj ka propozuar si më lartë.

Mbrojtësja e të akuzuarit L.D., av. M.Z.S., pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 dhe 2 të KPP-së për faktin se është i paqartë dhe se nuk janë paraqitur faktet vendimtare dhe arsyetimi i fakteve që kanë të bëjnë me përshkrimin faktik dhe ligjor të veprës penale siç kërkohet me ligj. Sipas mbrojtëses gjykata nuk ka paraqitur se nga cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara faktet se i pandehuri L.D. ka qenë i motivuar me ideologji ekstreme radikale islame. Po ashtu sipas mbrojtjes aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e vërtetimit të veprës dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit nuk ka vlerësuar në mënyrë të saktë dhe objektive deklaratën e të pandehurit dhënë në hetuesi dhe në fazat tjera të hetimit, ndërsa ia ka falur besimin vetëm deklaratës së të dëmtuarit dhe dëshmitari I.M., i cili është shok i ngushtë me të dëmtuarin. Përpos shkeljeve esenciale, mbrojtësja e të akuzuarit L.D. aktgjykimin e shkallës së parë e ka atakuar edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, me pretendimin se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i paqartë, kontradiktor, i mangët si dhe i pambështetur në prova por vetëm në supozime, kjo për shkak se sipas mbrojtjes nuk është arritur të vërtetohet si i pandehuri L.D. ka qenë i motivuar me ideologji ekstreme radikale islame, pra nuk janë formuar elementet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri. Mbrojtja konsideron se në bazë të provave të ofruara ndaj të pandehurit duhej të rëndonte akuza për kryerjen e veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.4 lidhur me par.1 të KPRK-së. Gjithashtu, aktgjykimin e ankimuar e ka ankimuar edhe për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, me pretendimin se gjykata nuk ka arritur ta vërtetoj plotësisht gjendjen faktike madje se ajo është vërtetuar gabimisht duke shkaktuar kështu shkelje në dëm të pandehurit. Sipas mbrojtjes, qëllimi i të pandehurve për tu takuar me të dëmtuarin ishte vetëm për ti sqaruar me të rreth një postimi në Facebook dhe jo për ta sulmuar ashtu siç pretendohet në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë. Mbrojtja shton se takimi nuk është arritur të realizohet te ambienti i televizionit T7 për shkak të lëvizjes së shpejtë të dëmtuarit dhe kësisoj të pandehurit kanë vendosur që ta ndjekin nga pas me qëllimin e vetëm që të sqarohen me të. Po ashtu sipas mbrojtjes situata ka dalë jashtë kontrollit për shkak të fyerjes së të dëmtuarit, pasi që sipas mbrojtjes i pandehuri e kishte ftuar të dëmtuarin me fjalët “më fal a bon veç pak qitu“, kurse i dëmtuari e kishte fyer të njëjtin me fjalët “çfarë doni ju majmuna”, duke e nxitur kështu situatën drejt eskalimit. Mbrojtja nuk është pajtuar as me vendimin për sanksionin penal të shqiptuar

duke theksuar se shkeljet procedurale të cekura si më lartë në ankesë kanë ndikuar në marrjen e një dënimi jo të drejtë dhe tejet të rëndë, i cili dënim sipas mbrojtjes nuk justifikon qëllimin e dënimit dhe se i njëjti është në disproporcion me përgjegjësinë penale, peshën e veprës penale, personalitetin e të pandehurit dhe rrethanat e tij personale, familjare e sociale. Sipas mbrojtjes, gjykata nuk ka vlerësuar dhe nuk ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese të cilat kanë ekzistuar si dhe të njëjtat nuk i ka specifikuar veç e veç për secilin të akuzuar, ndërkaq sipas mbrojtjes gjykata nuk ka marrë fare parasysh faktin se i pandehuri L.D. është i martuar, baba i dy fëmijëve të moshës së mitur, me arsimim të ulët, ka të kryer vetëm shkollën fillore, është punëtor i gjendjes së dobët ekonomike, duke pretenduar kështu se dënimi i shqiptuar është tejet i rëndë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av. R.K., ka paraqitur ankesë për shkak të pretendimeve se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, saktësisht dispozitës së përcaktuar me nenin 384 par.1 nënpar 1.1 të KPRK-së, me pretendimin se përbërja e gjykatës nuk ka qenë e duhura për arsye se Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk ka kompetencë për të ngritur aktakuzë për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 i KPRK-së, ku sipas Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës janë përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësitë për zhvillimin e hetimeve dhe për ndjekjen penale, andaj bazuar në këtë ligj Prokuroria Speciale nuk ishte kompetente për ngritjen e kësaj aktakuze dhe nga kjo rrjedh se as Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk ishte kompetente për trajtimin e kësaj çështje dhe bazuar në këto fakte aktgjykimi i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Përpos shkeljeve esenciale, av. R.K. aktgjykimi e shkallës së parë e ka atakuar edhe për shkak të vendimi mbi sanksionin penal, me pretendimin se gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh vetëm rrethanat rënduese të cilat po ashtu i ka vlerësuar gabimisht për shkak se sipas mbrojtjes për të pandehurin K.H. nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese. Mbrojtja pretendon se rrethanat rënduese të paraqitura si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar nuk qëndrojnë për klientin e tij dhe se të njëjtat janë të pabazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit O.H., av. Rr.A. në ankesë thekson se mbrojtësit e të akuzuarve, në seancën e shqyrtimit fillestar e kundërshtuan kompetencën e Departamentit Special të Gjykatës Themelore për tu marr me gjykimin e kësaj çështje. Pasi me këtë çështje duhej të merrej Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës e jo Departamenti Special. Prokuroria Speciale nuk ka pasur kompetencë të ngrit aktakuzë për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 i Kodit Penal të Kosovës, e rrjedhimisht as Departamenti Special i Gjykatës Themelore në

Prishtinë nuk është kompetent për ta gjykuar veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185. Sipas nenit 3 paragrafi 5 i Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, përcakton se Prokuroria Speciale është kompetente dhe përgjegjëse për zhvillimin e hetimeve dhe për t'i ndjekur penalisht krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PSRK-së, në nenin 5 dhe në nenin 9 të Ligjit për prokurorinë speciale janë të përcaktuara kompetencat e veçanta dhe plotësuese të PSRK-së dhe janë renditur të gjitha veprat me të cilat kjo prokurori ka kompetencë të merret, por as në kompetencat e veçanta e as plotësuese nuk figurojnë vepra penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 i Kodit Penal të Kosovës (shih nenin 5 dhe 9 të Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 21, paragrafi 5, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përcakton se Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë zhvillon gjykon në të gjitha procedurat penale për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale. Lëndimi i lehtë trupor nuk është në kompetencë të Prokurorisë Speciale andaj as Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë. Të akuzuarit fillimisht kanë qenë të dyshuar për lëndim të lehtë trupor, sipas cilësimit që i ka bërë prokurori A.H. dhe policia, por me kalimin e rastit në Prokurori Speciale, duke qenë se prokuroria Speciale nuk ka qenë kompetente për të zhvilluar hetime për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor, është ndryshuar cilësimi në “nxitja e përcarjes dhe mosdurimit nga neni 141 paragrafi 3 lidhur me paragrafin t lidhur me neni 31 të KPRK-së. Me konstatimin e prokurorit se nuk kemi të bëjmë me veprën penale nga neni 141 KPRK-së rasti është dashur të rikthehet prapë në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë, sepse vetëm kjo është kompetente për të ngritur aktakuzë lidhur me këtë veprë. Aktgjykimi që ankimohet është marrë nga organi me inkompetencë lëndore andaj si i tillë duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim. Mbrojtja tutje shton se me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, gjykata e shkallës së parë i ka pasur parasysh vetëm rrethanat rënduese dhe atë, ato rrethana që ajo gabimisht i ka vlerësuar si të tilla edhe pse nuk paraqesin rrethana rënduese. Në aktgjykim fq. 23 thuhet: “si rrethana rënduese ka gjetur peshën e veprës penale të motivuara nga besimi fetar, këmbëngulësia e të pandehurve për të kryer veprën penale, rrezikshmëria e veprës penale në raport me lirinë e shprehjes, sjelljen e të pandehurve pranë gjykatës ku një zëri kanë deklaruar se nuk duam me u gjykua nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, qëndrimi i tyre se gjatë procesit gjyqësor nuk kanë pranuar gjykatën si institucion, nuk kanë pranuar bashkëpunimin dhe komunikimin e as mbrojtjen-avokatët, me këtë rast ata mbi bazën e bindjes se tyre fetare kanë bojkotuar institucionet, si dhe për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, gjykata si rrethanë rënduese ka marrë për bazë faktin se me këtë veprë penale cenohet një nga të drejtat vitale të njeriut. Tutje sipas mbrojtjes në veprimet e z. H. nuk ekziston asnjë rrethanë rënduese. Pësia e veprës penale e motivuar nga besimi fetar, e cekur në aktgjykim

nuk mund të merret si rrethanë rënduese, sepse është element i figurës së veprës penale nga neni 185 të KPK-së, andaj si i tillë duhet të trajtohet në kuadër të cilësimit ligjor të veprës së penale ku përfshihet minimumi dhe maksimumi i veprës e jo të trajtohet si rrethanë rënduese. Sy dyti, gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin gjyqësor gabimisht ka vërtetuar se vepra penale është kryer nga motive fetare. Vepra penale nga neni 185, parag. 3, do të kryhej vetëm nëse personi sulmon tjetrin, për shkak të fesë së tij, pra për shkak se i përket një grupi fetar, një gjuhe, apo një kombësie. Pala e dëmtuar V.S. nuk është sulmuar nga të akuzuarit për shkak se ai (V.S.), i takon apo s'i takon një grupi të caktuar fetar, kombëtar apo shoqëror. Nuk ka asnjë provë, që V.S. është sulmuar nga të akuzuarit për shkak të fesë së tij, apo mungesës së fesë së tij, por për shkak të provokimeve të rënda që ka bërë në rrjetin social, ku një pjesë e madhe e qytetarëve janë ndier të fyer nga videot dhe postimet e tij tallëse me profetët: Muhamedin dhe (Jezusin) Isain. Këmbëngulësia e të pandehurve e cekur si rrethanë rënduese, është e pabazuar pasi, i mbrojturi im dhe të akuzuarit tjerë kanë shprehur keqardhje që ka ndodhur ngjarja, dhe e tërë ngjarja ka ndodhur 3-4 sekonda, pas provokimit që V.S. ua bënë të akuzuarve duke i quajtur majmuna, kur këta i kërkojnë atij të bisedojnë tek kafiteria image, dhe nuk kanë treguar kurrfarë këmbëngulje për kryerje të veprës penale. Mendimi i të mbrojturit tim O.H. se, nuk dëshiron të gjykohet nga gjykata që ka gjykuar rastin nuk mund të merret si rrethanë rënduese. Qëndrimi i të akuzuarve se nuk pranojnë të gjykohej nga kjo gjykatë, është mendim i tyre i shprehur, edhe këta kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre njësoj si edhe pala e dëmtuar që pretendon se ka të drejtë të shpreh mendim dhe të tallet me profet, andaj mospranimi i gjykimit nga gjykata që ka gjykuar rastin nuk është dashur të merret kurrë si rrethanë rënduese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, por të vlerësohet si shprehje e mendimit të tyre se “gjykata që po i gjykon nuk është e mirë dhe ata duan një gjykatë tjetër”. Nuk ka raste në praktikën gjyqësore të Kosovës, që ndokush për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 të dënohet me 2 vite burgim efektiv. Mbrojtja është e bindur se me shumë se gjysma e dënimit të shqiptuar të akuzuarve u është bërë për shkak të vlerësimit të atyre rrethanave që gjykata i ka vlerësuar si rrethana rënduese. Sipas nenit 69 parag.2 të KPK-së, dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit. Një vendim gjyqësor nuk mund të konsiderohet i ligjshëm, me vet faktin se dënimi i shqiptuar është midis minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, pasi neni 69 i Kodit Penal të Kosovës, kërkon që gjykata përveç se dënimin ta shqiptoj brenda minimumit dhe maksimumit edhe të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në Kod Penal si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën e caktuar ose me dënimin. Gjithashtu ky nen përcakton që dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit. Konsiderojmë se dënimi është joproporcional

me peshën e veprës. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, megjithëse i përmend, nuk i ka vlerësuar fare e as marrë parasysh rrethanat lehtësuese, si: faktin që i mbrojturi ishte i moshës së re, ndaj tij nuk është zhvilluar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, se i njëjti është dorëzuar, vet e ka thirr policinë dhe është dorëzuar, nuk është marrë parasysh as keqardhja e shprehur nga ana e tij për rastin.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pasi analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës dhe duke vlerësuar pretendimet ankimore, e duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, nga fakti se dispozitivi është i qartë dhe i kuptueshëm pasi që në të përfshihen të gjitha rrethanat dhe elementet që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe si i tillë është në përputhje të plotë me arsyetimin e tij e në të cilin arsyetim janë paraqitur arsyet e plota dhe të qarta për faktet vendimtare së bashku me arsyet me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike të kësaj çështje penale, ndërsa nuk përmban asnjë shkelje tjetër e cila kishte për të kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjyimit të ankimuar.

Përkitazi me pretendimin ankimor të ngritur nga mbrojtësit e të pandehurve O.H. av. Rr.A. dhe K.H. av. R.K. se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 të KPPRK-së duke kundërshtuar kompetencën e Departamentit Special për të trajtuar çështjen në fjalë duke potencuar se Prokuroria Speciale nuk ka pasur kompetencë të ngrit aktakuzë për vepër penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 i KPRK-së e rrjedhimisht as Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk ka qenë kompetent për të gjykuar veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 185, pastaj se vepra në fjalë nuk mund të trajtohet nga departamenti special as sipas kompetencave të veçanta dhe plotësuese të PSRK-së, ky kolegji penal një pretendim të tillë e gjen si të pabazuar për faktin se referuar shkresave të lëndës, ashtu si edhe vet mbrojtja potencon në ankesat e tyre, në këtë çështje penale Prokuroria Speciale kishte zhvilluar hetim për shkak të veprës penale Nxitja e përçarjes dhe mos durimit nga neni 141 paragrafi 3 lidhur me neni 31 të KPRK-së, e cila vepër penale hyn në kapitullin XIV (veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës) të Kodit të procedurës penale e për të cilën vepër penale në kuptim të nenit 9 par.1 nënpar.1.1 të ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës

së Kosovës, si kompetencë e veçantë lëndore, rezulton se është në kompetencë të saj për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të këtyre veprave penale. Fakti se gjatë zhvillimit të procedurës së hetimeve nga kjo Prokurori ka rezultuar në elementet e veprës tjetër penale duke e ngritur aktakuzën për veprën penale objekt i akuzës, në aspektin ligjor nuk nënkupton se është jo kompetente, si pretendon mbrojtja në këtë çështje penale, duke marrë për bazë se në këtë rast aktakuzën e kishte ngritur PSRK-ja, andaj konform nenit 18 par.1 të Ligjit për Gjykatat rrjedh se kompetente për të gjykuar në këto raste është Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila dispozitë parasheh decidivisht se: *Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet pasuese.*

Gjykata e Apelit gjen se Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me këto prova ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta, objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me *vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike* të paraqitura nga mbrojtësit e të akuzuarve L.D. av. M.Z.S., K.H. av. R.K. dhe O.H.me av. Rr.A., kolegji penal i kësaj gjykate gjen se, gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për shkak se me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit L.D., K.H. dhe O.H., kanë kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së, me ç'rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ligjshëm duke marrë aktgjykim me të cilin të akuzuarit i ka shpallur fajtor ngase në veprimet e të akuzuarve L.D., K.H. dhe O.H. përmbushen elementet e veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së.

Kjo Gjykatë vlerëson si të drejta përfundimet e gjykatës së shkallës së parë e cila deri tek kjo gjendje faktike ka ardhur pas administrimit të provave personale dhe materiale si: deklaratat e të dëmtuarit të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit V.S. i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.11.2023 ka deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në polici dhe se në natën kritike ka qene i ftuar në televizionin T7 si panelist dhe diku afër orës 22:00, ka përfunduar emisioni dhe me koleget e emisionit janë dakorduar që të vazhdojnë pas debatit për një pije diku në qytet, moti nuk ka qenë i mirë atë natë, shpejt kanë hyrë në vetura, ku ai ka hyrë në veturë me I.M, ndërsa

L.K. me “A.” është nisur drejt qendrës së Prishtinës, fillimisht, nuk e kanë caktuar lokacionin për të shkuar, por përmes “whatsapp” janë dakorduar që shkojnë në kafiterinë “I.” në Breg të Diellit në Prishtinë, kur kanë arritur te kafiteria kanë dalur shpejt nga vetura që të futen në kafiteri, dhe me të arritur pranë kafiterisë një person me dukje islamik radikal fundamentalist L.D., e ka thirr nga mbrapa dhe i ka thënë: ‘mfal a bon veç pak qëtu’, është kthyer e ka parë dhe nuk ka thënë asgjë dhe shpejt ka tentuar të futet në lokal, dhe duke qenë kubëzat e lagështa ku e ka humbur balancën dhe aty është goditur nga mbrapa në kokë nga L.D. dhe pastaj dy personat e tjerë as që i ka parë se ka qenë i rrëzuar në shkallë të lokalit dhe vetëm ka bërëtitur për ndihmë, e ka vërejtur se është goditur edhe nga persona të tjerë, por nuk i ka identifikuar pasi që e ka mbrojtur fytyrën dhe goditjet i ka marrë në pjesën e sipërme të kokës, dikush nga sulmuesit ka poseduar një ore digjitale e madhësisë standarde me teha metalik dhe duke e grushtuar në kokë rrëshqitja e orës e ka goditur në pjesën anësore të ballit nga ka ardhur e gjithë gjakderdhja, pastaj, kolegu I.M. e ka tërhequr nga pas njërin nga ta duke e kapur nga dora apo krahu dhe e mban që të mos sulmoj dhe dalin persona nga kafeneja për ti ndihmuar, ku më pas të pandehurit janë tërhequr, është futur brenda dhe ka shkuar në banjo pasi që kishte shumë gjak i cili nuk ndalej, ku pastaj një mik ia ka sjell një ore, por që i ka thënë se nuk është e tij, por e sulmuesve, pas diku rreth 10 minutave ka arritur policia së bashku me ndihmën e shpejtë, të cilët edhe e kanë marrë në pyetje, dikush nga kafeneja i ka marrë numrin e tabelave të veturës së të pandehurve, të cilin numër e ka dorëzuar në polici, në sulm kanë qenë të përfshirë të tre të pandehurit, njeri nga vëllezërit H. e ka pasur orën dhe është i bindur se të dy vëllezërit e kanë goditur, mendon që të pandehurit i kanë përcjell kur kanë dalur nga emisioni sepse nuk e kanë ditë se në cilën kafe po shkojmë, dy personat tjerë ka deklaruar se nuk i ka parë në fytyrë, por vetëm nga anash dhe e dinë që kanë qenë 3 persona L.D. dhe dy tjerë krahas tij. dhe sikur të mos ishte I.M. sulmi do të vazhdonte, ka shtuar se në atë ditë ka qenë një lajm ku një hoxhë i Prizrenit shpërblehet me “M.”, dhe postimi i tij i pare ka qenë kritik se si një hoxhë po shpërblehet me mercedes nga xhemati dhe BIK, në muajin e shenjtë të Ramazanit ku duhet të promovohet modestia, me një dhuratë tepër luksoze. Pra, kritika ka qenë se hoxhallarët si njerëz të show bizit, e jo si prijës fetar dhe pas kësaj ka pasur edhe një barcoletë për profetin Isa dhe Muhamedin, kjo batutë lidhet me veturën e cila tregon se Profeti Muhamed e sheh në parajsë Profetin Isa (Jezu Krishtin) me një veturë të shtrenjtë luksoze dhe pyet qysh ju keni një veturë të shtrenjtë e unë jo, dhe i njejtë i thotë se unë jam i biri i Zotit, batutat e tilla, me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës nuk përbejnë krim, por liri edhe kreativitet dhe kush preket nga kjo është çështje tjetër. Me pas deklaroi se kur i pandehuri ju ka drejtuar “a bon veç pak qëtu”, i njëjti është përgjigjur se pamja e të pandehurit, pozita e trupit e aktivizuar në formë të kanosjes e cila nuk ishte e relaksuar, dukej

sikur përgatitje për kanosje dhe sulm dhe nuk kishte ton miqësor që përdorej, dritat e kafiterisë kanë qenë dhe ka mundur me pa, nuk ka qenë errësirë pasi që dritat dhe pamja ka qenë shumë mirë dhe ka qenë terr se ka qenë kohë e mbrëmjes, gjatë rrugës për në lokalin “I.” ka deklaruar se nuk ka vërejt diçka, por pasi që ka ndodh krejt rasti Iliri i ka thënë se mu ka dok sikur dikush po i përcjell. Ka shtuar se rastin e ka përjetuar rëndë, është presion për të pasi që shkakton pasiguri në lëvizje dhe duhet të mbyllesh, të cenohet lëvizja sepse mund të ndodh përsëri, pasi që sulmi është i organizuar dhe ka tendenca terroriste me qëllim të frikësimit të njerëzve të opinionit publik, mediave dhe masës popullore, pasi që në këtë gjykatë të pandehurit nuk e respektojnë këtë gjykatë dhe kjo vërteton tendencën ekstremiste të tyre. Ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datë 29.05.2023, ka deklaruar se dëshmitari I.M. ka arritur ta largoj njërin nga personat që më ka sulmuar, ndërsa dy persona tjerë kane vazhduar që të më godasin ndërkohë, ndërsa pjesa tjetër e deklaratës është e njëjte me deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Nga deklarata e dëshmitarit I.M., dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 23.11.2023 i cili ndër të tjera ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklaratës së dhënë në polici me datë 30.05.2023, në natën kritike ka deklaruar se ka qenë në emision në T7 dhe pas debatit disa miq u kanë treguar se janë në një kafe ku shkojnë shpesh dhe kanë vendosur me shku, kanë shkuar me veturën e tij ku me të ka qenë edhe V.S., ndërsa drejtori i T7 L. ka qenë me veturën e tij, kanë shkuar në kafiterinë “I.”, që është larg dikur rreth 5-6 km, kur kanë mbërritur te kafiteria “I.” nuk ka pas parking dhe veturën e kanë lënë pak më larg dhe kanë dal prej veture, ku V. ka dal i pari ka qenë 10 hapa para tij dhe në atë rast ka dëgjuar disa hapa duke vrapuar pas tij dhe pastaj V. ka filluar të vrapoj deri te hyrja e restorantit ku edhe e kanë sulmuar duke e rrëzuar dhe pastaj duke e goditur në pjesën e kokës, pastaj jam afruar dhe njërin prej tyre e ka kapur nga mbrapa dhe e ka larguar nga V., të cilët pastaj kanë ikur, ndërsa V. ka mbetur i përgjakur. Ka shtuar gjatë rrugës për të shkuar nga T7, deri tek kafiteria “I.” e ka vërejtur që një veturë po i rrin afër gjatë gjithë kohës, por nuk i ka kushtuar vëmendje pasi që ka menduar se është L., pasi që në natën kritike, ka deklaruar se ka qenë gjysmë errësirë sepse ka pasur ndriçim, në momentin kur kanë kaluar personat duke vrapuar në natën kritike, kanë qenë tre persona, ndërsa mbi trupin e V. i ka parë vetëm dy persona, detajet nuk i ka parë se ka qenë punë sekondash. Ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datë 30.05.2023, ka deklaruar se kemi shkuar së bashku me V. tek kafiteria “I.”, pasi që e kam parkuar veturën, i kam vërejtur tre persona që na kanë thënë diçka por nuk më kujtohet saktë se çfarë, e kanë mbërrir V. tek shkallët e lokalit dhe kanë filluar ta godasin,

kam vrapuar dhe e kam larguar njërin nga sulmuesit ndërsa dy tjerët kanë ikur, ndërsa pjesa tjetër e deklaratës është e njëjtë me deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Ndërsa, nga analizimi i deklarimeve e të akuzuarve të dhëna fazat e procedurës penale në këtë çështje penale, nga deklaratimet e tyre, në mes tjerash, përpos se nuk kishin mohuar sulmin fizik ndaj të dëmtuarit në ditën kritike, vërtetohet se ata ishin ndier të fyer nga postimet e të dëmtuarit V.S. në rrjetin social “facebook”, e të cilat postimet kanë qenë të ndërlidhura me çështjen fetare, respektivisht me Profetin Muhamed dhe Isa, e që nga kjo rezulton se motivi i kryerjes së veprës penale nga të akuzuarit është për arsytet e motiveve fetare, duke pretenduar se të akuzuarit në ditën kritike kishin shkuar te i dëmtuari për ti tërhequr vërejtjen që të mos bëj postime të tilla duke qenë se është edhe muaji i Ramazanit dhe mundësisht ti fshij ato.

Nga raporti informues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr.ref: 06/1-03/86-2023, datë 1 2.04.2023 bashkangjitur po ashtu edhe raporti i shpejtë me përshkrimin e vendit të ngjarjes me nr. 2023-AD-1261 të datës 01.04.2023, gjykata ka vërtetuar se me datë 11.04.2023 rreth orës 22:45 tre persona e kanë sulmuar të dëmtuarin V.S. duke i shkaktuar lëndime në kokë dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes me veturën BMW, ngjyrë e zezë, me targa

Nga raporti fillestar i incidentit i Policisë së Kosovës në Prishtinë me nr. të rastit 2023-AD1261 të datës 11.04.2023, gjykata ka vërtetuar se me datë 11.04.2023, në ora 22:39 është raportuar për incident në Prishtinë, në rrugën “I.M.” tek lokali “I.”, dhe policia në vendin e ngjarjes ka arritur në ora 22:58, e nga i cili incident ka pasur lëndime të lehta trupore i dëmtuari V. S.

Nga fletëthirrja e Ndhmës së shpejtë mjekësore se bashku me konstatimin e mjekut datë 11.04.2023, gjykata ka vërtetuar se është thirrur ndihma e shpejtë me datë 11.04.2023 në ora 22:50, ku ndihma e shpejtë ka shkuar në ora 22:55 dhe ka gjetur të dëmtuarin V.S. në plagë të hapur - gjakderdhje në anën e djathtë të kokës, ku i është bërë fashimi i plagës dhe është transportuar në Qendrën e Klinikës Emergjente.

Nga fletëlëshimi i mjekut nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Klinika Emergjente në Prishtinë me nr. të protokollit 23393 të datës 11.04.2023, vërtetohet se i dëmtuari V.S. është dërguar me urgjencë në këtë klinikë për shkak të lëndimit të kokës pas incidentit.

Nga raporti njoftues i Policisë së Kosovës DKT në Prishtinë me nr. ref: 06/1-03/12-2023 datë 06.06.2023, mbi analizimin e ekzaminimit të pajisjes (aparati telefonik) i sekuestruar nga i pandehuri L.D., gjykata ka vërtetuar faktin se i akuzuari L.D. përmes rrjeteve sociale ka komunikuar me persona të ndryshëm rreth armëve të zjarrit, si dhe janë gjetur komunikime janë shkëmbyer edhe disa fotografi të tyre dhe dy video të ushtrave të organizatave terroriste të cilat operojnë në shtetet e lindjes se mesme dhe bisedohet rreth botimit të një reviste e cila është në gjuhën angleze ku “shteti islamik e sqaron akiden”. Po ashtu, është gjetur një komunikim ku është dërguar një fotografi ku shihen dy ushtarë të armatosur, ku njeri nga ta thuhet se është P.M. me nofkën “E.M.”. Po ashtu, ka zhvilluar komunikime, në të cilat është dërguar edhe një fotografi e L.M., ku i akuzuari shprehet: “Me dal me gju me kallash, Allahu na mundësoftë me gjuajt ne kon duhet”. Po ashtu, nga administrimi i kësaj prove janë gjetur fotografi ku shihet i akuzuari L.D. fotografuar në oborrin e tij me armë automatike AK47, si dhe me flamur të ISIS-it.

Nga akt-ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit të çështjes lëshuar nga Specialisti i Mjekësisë Ligjore - IML në Prishtinë me nr.ref. Pr - 75, datë: 24.05.2023 për të dëmtuarin V.S. gjykata ka vërtetuar që i dëmtuari me rastin e sulmit ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës dhe qafës, si dhe plagës shquese ndrydhëse në regjionin tëmthoro-ballor të anës së djathtë të kokës, të cilat dëmtime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, mbretës (jo të mprehtë), e të cilat dëmtime bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme në shëndet.

Nga shikimi dhe vlerësimi i CD - barcoleta e postuar në video nga i dëmtuari V. S., gjykata ka vërtetuar faktin se i dëmtuari V.S. në rrjetin e tij social në facebook, ka postuar një video të llojit sarkazëm që ndërlidhet me rastin kur një imam i Kosovës ka pranuar një dhuratë nga xhemati i tij. Në këtë video i dëmtuari V.S. shprehet: “Nëse të pyesin se kush është krijuesi yt, ti thuaj Allahu Xheleshannehu, nëse të pyesin kush është peygamberi yt, ti thuaj Muhammedi Alejiselam, nëse të pyesin kush është udhërrëfyesi yt, ti thuaj Kurani i krijimit, ndërsa kur të pyesin se cilin kerr ti e don, ti thuaj mercedes”. I dëmtuari V.S., ka postuar në rrjetin e tij në facebook një batutë që ndërlidhet me fenë islame, respektivisht me Profetin Muhammed dhe Profetin Isa (Jezu Krishti) me përmbajtjen si në vijim: “Profeti Muhamed e sheh në parajsë Profetin Isa (Jezu Krishtin) me një veturë të shtrenjtë luksoze dhe pyet qysh ju keni një veturë të shtrenjtë e unë jo, dhe i njëjti i thotë se unë jam i biri i Zotit”.

Andaj, gjykata e shkallës së parë në vlerësim të këtyre provave materiale dhe personale dhe duke vlerësuar edhe deklaratat e të pandehurve të dhëna gjatë fazave të procedurës penale, ku të akuzuarit nuk e mohojnë veprimin - sulmimin ndaj të dëmtuarit, por motivin si pretendohet me aktakuzë, rezulton se edhe gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë plotë dhe të drejtë duke ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve përmbushen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të Lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së, duke qenë se me këto prova është vërtetuar se sulmi i të akuzuarve ndaj të dëmtuarit ishte i motivuar nga aspekti fetar e që rrjedh nga postimi në profilin e të dëmtuarit, i cili ka qenë i ndërlidhur me fenë islame.

Gjykata e Apelit përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësve për shkak të shkeljes së ligjit penal të njëjtin e gjen si të pabazuar për faktin se meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë edhe ligji penal është zbatuar drejtë duke gjetur se në veprimet të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale të Lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së, për të cilën veprë edhe janë shpallur fajtor dhe gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, përkitazi me pretendimin e Prokurorisë për një dënim më të ashpër për të akuzuarit, me pretendim se në këtë rast gjykata e shkallës së parë të akuzuarve L.D., O.H. dhe K.H. për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 e nenin 31 të KPRK-së, iu ka shqiptuar dënim tejet të butë dhe në disproporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, peshën e së njejtës dhe si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, i gjen të pabazuar dhe si të tilla të përgjithësuara ngase në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë të cilën gjykata e shkallës së parë nuk e mori parasysh ndërsa për këto të pretenduar si të tilla ishin vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë.

Ndërsa në anën tjetër Gjykata e Apelit pretendimet e mbrojtjes për një dënim më të butë ndaj të pandehurve i gjen si të bazuara ngase si me të drejtë potencojnë mbrojtja në ankesën e tyre në këtë rast gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar si rrethanë rënduese motivin nga besimi fetar e që në fakt është element kualifikues i figurës së veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të akuzuarit prandaj edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykata nuk mund të vlerësohet si rrethanë rënduese elementi i veprës penale, andaj kjo Gjykatë duke rivlerësuar rrethanat e

konstatuara nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, ku si rrethanë lehtësuese është vlerësuar se të njëjtit janë të moshës relativisht të re dhe faktin se janë penduar për sulmin ndaj të dëmtuarit, ndërsa në anën tjetër si rrethana rënduese është vlerësuar rrezikshmëria e veprës penale në raport me lirinë e shprehjes, sjelljen e të pandehurve në gjykatë, nuk e kanë respektuar rregullin dhe rendin në gjykatore, qëndrimin e të pandehurve pranë gjykatës ku njëzëri kanë deklaruar nuk duam me u gjyku nga gjykata me këto ligje, por vetëm në bazë të ligjeve të Allahut, qëndrimi i tyre se gjatë gjithë procesit gjyqësor nuk kanë pranuar gjykatën si institucion, nuk e kanë pranuar bashkëpunimin dhe komunikimin e as mbrojtjen – avokatët e tyre, me këtë rast ata mbi bazën e bindjes se tyre fetare kanë bojkotuar institucionet, poashtu duke pasur parasysh edhe natyrën e kësaj vepre penale nëpërmjet të cilës është tentuar të cenohet liria e shprehjes si e drejte fundamentale e çdo njeriut, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale nga të akuzuarit dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve dhe me intensitetin e rrezikimit dhe pasojës - lëndimeve trupore të shkaktuara të dëmtuarit, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit për parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, të parandaloj peronat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektim të ligjit konform nenit 38 të KPRK-së.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.16/2024, datë: 09.09.2024

Bashkëpunëtorë Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Gresë Latifi

Vaton Durguti

Kreshnik Radoniqi

Numri i lëndës: 2023:089479
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06205546

Mentor Bajraktari